

MARRËVESHJE PËR SHITJE KUOTE

Kjo marrëveshje për blerje kuote nënshkruhet sot me date 20.09.2021 midis dhe nga palët e mëposhtme:

A. Z. Martin Mane, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 11.07.1997, me banim në Kompleksion Rezidencial Rrolling Hills, Farkë, Tiranë, Shqipëri, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportës nr. BR2789989 (këtu e tutje referuar si "**Shitësi**");

dhe

B. Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Njesia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë , regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga Administratori **Z. Edlira Muka**, shtetase shqiptare, e lindur në Tiranë, në 03.02.1983, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 034271384 dhe me numër personal I35203147R (këtu e tutje referuar si "**Blerësi**").

Palët kanë vendosur dhe rënë dakord si më poshtë:

vijon:

1. Shitësi gëzon të drejtën e plotë dhe ekskluzive të pronësisë dhe zotërimit të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **1.000 LEK** (një mijë lekë), të cilat përfaqësojnë **100%** (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "**MM Trading**" sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në adresën Rruga "Papa Gjon Pali II", Ndertesa Nr.12, Kati 11 -te, Zyra nr.1206, Njesia bashkiake nr.2, Tiranë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me NUIS: M01706031C, përfaqësuar nga Administratori Z. Martin Mane ("**Kuota**").
2. Shitësi shet, transferon dhe dorëzon pronësinë e plotë dhe zotërimin e Kuotës të cilësuar këtu më sipër, konkretisht të **1 (një)** kuote me një vlerë nominale prej **1.000 LEK** (një mijë lekë), e cila përfaqëson **100%** (një përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë 'MM Trading' sh.p.k. dhe të gjitha të drejtat e detyrimet që ai gëzon si ortak, ja kalon blerësit, i cili pranon t'f blejë, për një çmim të barabartë me **1.000 LEK** (një mijë lekë) (këtu e tutje referuar si "**Çmimi**").
3. Shitësi deklaron se Blerësi i ka paguar Shitësit çmimin e plote prej 1.000LEK (një mijë lekë) në ditën e firmosjes se kësaj marrëveshje.
4. Shitësi deklaron që Kuota e transferuar në bazë të kësaj marrëveshjeje është e lirë dhe e pastër nga çdo peng, barrë siguroese, kufizim, garanci e një tjetër natyre, kufizim ose nga ndonjë pengesë ligjore në përgjithësi.
5. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe ne cdo rast me shlyerjen e çmimit të shitjes, Shitësi nuk ka dhe nuk do të ketë ndonjë pretendim tjetër përkundrejt Blerësit në lidhje me blerjen e Kuotës së mësipërme. Me pagesën e plotë të Çmimit nga Blerësit, shitja quhet e kryer dhe Blerësi përfiton pronësinë e Kuotës.
6. Pas transferimit të mësipërm të Kuotës, Shitësi nuk gëzon më asnjë të drejtë ose titull mbi

Kuotën e mësipërme dhe Blerësi, të cilit kuota i është transferuar dhe dorëzuar, përsa i përket pronësisë dhe posedimit, do të gëzojë të drejtën t'a zotërojë, posedojë, përdorë, shfrytëzojë dhe disponojë ato me vullnetin e tij të lirë si pronar dhe posedues i saj. Blerësi gëzon të drejtën të ushtrrojë të gjitha të drejtat që rrjedhin nga e drejta e tij e pronësisë.

7. Palët kanë rënë dakord që Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k., nuk do të mbartë dhe nuk do të ketë asnjë përgjegjësi dhe pasojë financiare, ligjore ose penale në lidhje me çdo lloj detyrimi, penaliteti, shkelje, parregullesisë ose mospërputhje me ligje, akte nënligjore dhe rregullore të cilat mund të rezultojnë në lidhje me aktivitetin e shoqërisë MM Trading sh.p.k për periudhën para datës së marrëveshjes së shitblerjes së kuotës.
8. Blerësi do të vijojë me regjistrimin e nevojshëm të transaksionit në fjalë në Regjistrin e Biznesit të mbajtur në Qendrën Kombëtare të Biznesit vetëm pasi të jetë paguar Çmimi i plotë në përputhje me pikat (2) dhe (3) më sipër.
9. Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me ekzekutimin ose interpretimin e kësaj marrëveshje do të paraqitet për zgjidhje pranë Gjykatave kompetente të Tiranës.
10. Palët kontraktore sipas kësaj marrëveshje heqin dorë nga çdo e drejtë e ankimimi të kësaj marrëveshje.
11. Kjo marrëveshje hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

NË DËSHMI TË PALËVE, kjo marrëveshje u hartua në 2 (dy) kopje origjinale me nga 2 (dy) faqe secila, nga palët, të cilat me leximin e saj nënshkruajnë aktin në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

PALËT KONTRAKTORE

Shitësi



Z. Martin Mane

Blerësi



Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k

përfaqësuar nga Znj. Edlira Muka

